



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në baze të nenit 8 paragrafi 3.2 të rregullores 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik te OJQ-ve shpalle këtë:

THIRRJE PUBLIKE

Për dy përfaqësues nga grupi i Eksperteve të jashtëm, një nga OJQ dhe një Ekspert për komisionin vlerësues.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale , ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ- ve të publikuar me date 20.06.2024 me titull:

Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

DSHMS, fton të gjithë të interesuarit, të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues , si ekspert të jashtëm ose përfaqësues të OJQ-ve, që të aplikojnë të jenë pjesë e Komisionit.

Kandidatet e interesuar duhet ti plotësojnë këto kriteret, të cilat ndikojnë në përzgjedhje si me poshtë:

- 1.Përvoja në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20 pike);
- 2.Përvoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike (10 pike);
- 3.Njohja e dokumenteve strategjike dhe politikave me prioritet në fushën e thirrjes publike (15 pike);
- 4.Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon thirrja publike (10 pikë);
- 5.Njohja e metodologjive ekzistuese brenda fushës së thirrjes publike (20 pikë);
- 6.Njohja e dokumenteve tjera relevante në fushën në të cilën është hapur thirrja publike (10 pikë)
- 7.Njohja e gjuhës së institucioneve kryesore dhe qëllimit të tyre të punës në fushat në të cilat është hapur thirrja publike(15 pike).

Afati aplikimit:20.06.2024 deri 28.06.2024

Kandidatet e interesuar duhet ti plotësojnë këto kriteret: Duhet te kenë diplome universitare; Të kenë përvojë në hartimin e projekteve brenda fushës së thirrjes publike.

Dokumentet e kompletuara të dorëzohen në adresën: Rr; Bardhyl Qaushi p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës. /Zyra e DSHMS-se.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE

Postal address: Bardhyl Qaushi Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 (0) 390 320 050

<http://kk.rks-gov.net/gjakove/>